



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 07.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 27.10.2023, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik ' "MALSIJAJ COMPANY" SH.P.K. & "Sigoni" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pajimet dhe sinjalizimi i trafikut rrugor", Nr. i prokurimit- 632-23-9062-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-126 -111, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik ' "MALSIJAJ COMPANY" SH.P.K. & "Sigoni" sh.p.k., e dt.06.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pajimet dhe sinjalizimi i trafikut rrugor", Nr. i prokurimit- 632-23-9062-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-126 -111, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 01.11.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 01.11.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.06.11.2023, Grupi i Operatorëve Ekonomik ' "MALSIJAJ COMPANY" SH.P.K. & "Sigoni" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pajimet dhe sinjalizimi i trafikut rrugor", Nr. i prokurimit- 632-23-9062-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-126 -111.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 07.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse ju si konzorcium nuk keni plotësuar kriterin minimal të FDT-së, nuk e keni arritur vlerën 480,000.00€ dhe me këtë nuk keni plotësuar kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare:

Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	68
---	---	----

këtë arsye nuk ju janë kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së;

Sa i përket pretendimit të juaj se OE fitues nuk ka paraqitur dëshmi për makinën tharëse të tipit W-JETP901WAS4-380, kjo nuk qëndron pasi që OE Fitues me sqarime shtesë ka prezantuar dokumentin e emërtuar "Certifikata e kalibrimit dhe përshkrimi i makinës tharëse", dokumenti nr 2 në listë, ku është prezantuar katalogu i makinës tharëse WAS4 në të cilën tregohet se ka fuqi 350 kW. Pra OE fitues ka prezantuar dëshminë e kërkuar e cila është në përputhje me kërkesën minimale të DT-ës.

Sa i përket pretendimit tuaj se OE Fitues nuk ka prezantuar EN Standarde për pajisjet semaforike, kjo nuk qëndron pasi që OE Fitues me sqarime shtesë ka prezantuar dokumentin me titull: "EN Standardet për kontrollerin CROSS_CON_RS4_RS4S_2020" dhe "EN standardet për semaforët F6-230V_200 mm", dokumentet nr 3 dhe 4 në listë, ku janë prezantuar standardet EN 5056, EN 50293, EN 61508-1, EN 61508-2, EN 61508-3, EN 61508-6, EN 12368:2015, EN 50556:2011, EN 50293:2012, të gjitha këto nga prodhuesit e pajisjeve semaforike me të cilat OE Fitues ka autorizim për furnizim.

Këto certifikata tregojnë se prodhuesit kanë prodhime që janë konform EN Standardeve që janë kërkuar në DT.

Sa i përket pretendimit tuaj për autorizime, ju njoftojmë se autorizimet e prezantuara nga OE Fitues, janë dorëzuar sipas kërkesës së DT dhe secila ka vulën e prodhuesit, nënshkrimin dhe adresën e selisë përkatëse, prandaj edhe ky pretendim i juaji nuk qëndron.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gufaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës